



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo

Mungojnë:

Tom Doshi

Të ftuar:

Z. Sandër Lleshaj, Ministër

Znj. Mimoza Dhembli, Drejtoresh e Buxhetit,

Znj. Doris Andoni, Drejtoresh e drejtorise se Strehimit.

Znj. Anisa Ruseti, Nenkryetare e Bashkise Tirane

Z. Alban Dokushi, Drejtor i Pergjithshem i Drejtorise Juridike, Aseteve dhe Licensimit.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Mirdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Kourumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjen e rendit të ditës, shqyrtimi i aktit normativ për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor të vitit 2019.

Komisioni ynë është për dhënie mendimi dhe relatore është zonja Klotilda Bushka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zonja Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Buxhetit dhe zonja Doris Andoni, Drejtore e Strehimit; nga Ministria e Brendshme: zoti Sandër Lleshaj, nga Bashkia e Tiranës zonja Anisa Ruseti, nënkryetare e Bashkisë, dhe zoti Alban Dokushi Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Juridike, Aseteve dhe Licencimit.

Kush do ta bëjë prezantimin e aktit normativ?

Fjalën e ka zonja Ruseti.

Anisa Ruseti – Me vendimin e këshillit bashkiak Bashkia Tiranë ka shprehur pëlqimin e vet për dhurimin e apartamenteve familjeve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor. Këto apartamente janë në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe ndodhen në njësinë administrative numër 1, në godinat që quhen banesa sociale dhe që janë në Shkozë. Aktualisht, sipas të gjitha vendimeve, sipas të cilave këto banesa janë shpërndarë për poseduesit e banesave sociale në zbatim të ligjit të strehimit dhe sistemit të pikëzimit dhe të gjithë dokumentacionit përkatës. Aktualisht ne kemi 17 apartamente të lira, për të cilat shprehim dakordësinë edhe në bazë të vendimit të këshillit bashkiak për t'u kaluar familjeve, të cilat janë prekur nga tërmeti me humbje të jetëve njerëzore. Ne kemi marrë edhe një vendim tjetër për mobilimin e këtyre banesave, duke qenë se familjet që

do të strehohen aty nuk kanë asnjë orendi shtëpiake. Do të donim të kishin një standard strehimi më të mirën e mundshme, por për t'ua bërë edhe më të lehtë akomodimin nga bashkitë e veta inicuese që janë në Durrës dhe në Thumanë për të ardhur në Tiranë, do të vijojmë me një vendim të dytë, i cili është mobilimi i këtyre banesave sociale. Banesat do t'i kalojnë në pronësi individit pasi ata kanë rënë dakord në lidhje me strukturën e apartamentit dhe me një vendimmarrje të tyre për t'u transferuar nga Bashkia e Thumanës, Durrësit apo nga apartamentet në Kombinat. Me transferimin e tyre në këto banesa do të vazhdojmë me aktin e dhurimit.

Faleminderit!

Ulsi Manja– Po, faleminderit, zonja Ruseti!

Ministri i Brendshëm do të shtojë diçka lidhur me aktin normativ.

Sandër Lleshaj – Akti normativ është propozim i qeverisë, në fakt, propozuar nga ministri i Brendshëm dhe ai i Financave. Bëhet fjalë për 17 apartamente, të cilat do të autorizohet bashkia për t'i dhuruar, në zbatim të vendimit të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. U jepet hapësira bashkive për të dhuruar. Synimi është minimizimi i dhimbjes së qytetarëve. Janë marrë masat që të ndërmerren hapat administrativë dhe qytetarëve të mos u mbetet asnjëloj barre administrative për procesin e transferimit të pronësisë nga bashkia . Kjo masë është vetëm njëra nga masat e shumta që ka marrë qeveria në dobi të familjeve të prekura nga tërmeti.

Kështu që rekomandojmë të votohet ky vendim, nuk ka nevojë për diskutime të gjata!

Ulsi Manja- Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave a janë dakord?

Dakord.

Spartak Braho- Kush është pronar i këtyre banesave?

Anisa Ruseti -Bashkia.

Spartak Braho- Atëherë, pse duhet bërë me ligj kjo?

Klotilda Bushka – Është shumë e drejtë pyetja, por banesat sociale, të cilat do të dhurohen sot, sipas ligjeve aktuale për strehimin social, nuk mund të dhurohen, janë vetëm për përdorim me qira për persona të pastrehë, prandaj po bëhet një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për të sistemuar personat e dëmtuar nga tërmeti në këto banesa që janë boshe. Po bëhen me akt normativ, se përndryshe mjafton një vendim i këshillit i bashkiak dhe bëhej dhurimi.

Nuk mund ta ndryshojmë, sepse është rast përjashtimor, vetëm për çështjen e tërmetit. Nuk mund t'i shesim banesat sociale në vijimësi, por vetëm për tërmetin.

Fatmir Xhafaj- Unë mendoj se, kur ka raste të tilla të ngjashme, mjafton të vësh një klauzolë ndihmëse që Këshilli i Ministrave të argumentojë arsyet madhore. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë.

Klotilda Bushka - Kjo do të ishte zgjidhja më ideale, por kjo zgjidhje do të kërkojë kohë, sepse ndryshimet në ligj me procedurën normale nuk mund të bëhen dot kaq shpejt ndërkohë që njerëzit janë jashtë. Prandaj është zgjedhur mekanizmi i aktit normativ për 17 banesat që janë, dhe për ato që ndoshta kanë bashkitë e tjera, sepse këtu bëhet fjalë jo vetëm për Tiranën, por edhe për bashki të tjera. Në këto kushte, kjo është një masë e shpejtë për të zgjidhur këtë hall imediat. Mesa jam unë në dijeni, është ngritur një grup që po sheh të gjitha ndryshimet e mundshme ligjore, që nuk do të jenë vetëm për këtë rast, por për të gjitha raste e fatkeqësive natyrore.

Vasilika Hysi -Në nenin 1 thuhet: “dhurimi i 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë së Tiranës” dhe më pas në nenet e tjera thuhet edhe të njëjtit të tjera vendore. A ka ndonjë inventar që në nënjësitë e tjera vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore ka banesa?

Klotilda Bushka - Jo.

Mimoza Dhëmbi - Në dijeninë në tonë të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Strehimit, banesa sociale ka në 8 bashki të vendit. Ndërkaq gjatë këtyre viteve ne kemi investuar në adaptimin e objekteve shtetërore në banesa sociale, pra janë disa bashki që kanë fond banesash sociale, por rastisi që Bashkia e Tiranës i ka bosh 17 apartamente. Ndërkohë, një ose disa prej këtyre banesave mund të mbeten vakante, mund të përdoren për këtë qëllim.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka- Pra, iu jep mundësi këshillave bashkiakë që kur t'i kenë të lira, t'i përdorin.

Ulsi Manja- Ju lutem, akti normativ është i përcaktuar për tërmetin e datës 26.11.2019. Ky akt normativ nuk lë hapësirë që të vlejë edhe për raste të tjera. Që të jemi të qartë është një akt normativ që nuk u jep të drejtën bashkive që në ardhmen, kur nuk ka tërmet, t'ia dhurojnë të tretëve.

A ka pyetje?

Kush është dakord në parim me aktin normativ? Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. .

Neni 6. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Akti normativ dhe raporti përkatës bashkohen me raportin e komisionit përgjegjës dhe të kalojnë sot për votim në seancë plenare.

Faleminderit!

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

MBYLLET MBLEDHJA